



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVA BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKA FEDERACIJA KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

KOMISIONI I GARAVE

2022-23

Prishtinë, 25/10/2022


Nr. 599 Dt. 25.10.2022
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

VENDIM Nr. 5/2022

Komisioni i Garave i Federatës së Basketbollit të Kosovës, në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të Federatës së Basketbollit të Kosovës, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e vet të mbajtur në datën e lartpërmendur, në përbërje të plotë prej Kryesuesit Leart Hoxha dhe anëtarëve Valdet Spahija dhe Ylli Hoti, shqyrtoi dhe unanimisht miratoi këto vendime dhe rekomandime:

1. Komisioni ka shqyrtuar situatën me obligime të pashlyera financiare të klubeve ndaj FBK-së, konform kompetencave të veta dhe vendimit nr 4 të Komisionit, të miratuar javën e kaluar. Komisioni ka vendosur që të gjitha klubet e Superligës obligohen që deri të premtën, më 28.10.2022 duhet të shlyejnë këto obligime ndaj FBK-së:
 - a) Këstin e muajit shtator nga marrëveshja me FBK-në për shlyerje të obligimeve
 - b) Borxhet nga informatorët e deritashëm
 - c) Borxhet tjera të papaguara gjatë këtij sezoni.Klubet që nuk shlyejnë obligimet e lartë-cekura ndaj FBK-së, do të suspendohen nga garat, konform dispozitave të marrëveshjes dhe/ose dispozitave të nenit 46 të Propozicioneve të Garave.
2. Për klubet e ligave tjera, situata financiare dhe obligimet e pashlyera do të trajtohen dhe vendimi përkatës do të miratohet në prag të përfundimit të ciklit të parë të

Në emër të Komisionit të Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës:


Leart Hoxha
Kryesues i Komisionit

KËSHILLË JURIDIKE:

Palët e pakënaqura me Vendimet e Komisionit të Garave mund të parashtrojnë ankesë pranë Komisionit Arbitrar të FBK-së, në formën dhe brenda afateve të përcaktuara me aktet normative të FBK-së.

Supported by:



TEB

General Sponsor:

Golden Sponsors



Silver Sponsors



Youth Basketball supporters





FEDERATA E BASKETBOLLIT TE KOSOVES
KOSOVA BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKA FEDERACIJA KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 599 Dt. 25.10.2022
PRISHTINË • PRISHTINA • PRISTINA

ARSYETIMI I KOMISIONIT TË GARAVE VENDIMI Nr. 5/2022

Gjatë vendimmarrjes lidhur me pikën 1 të Vendimit Nr.5/2022, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

I: Klubet e Superligës, i janë nënshtruar kriterëve për licencim për sezonin 2022/23, të miratuara nga Bordi i FBK-së. Pjesë e kriterëve për licencim ka qenë edhe shlyerja e një pjese të obligimeve financiare të klubeve nga sezonet paraprake dhe arritja e një marrëveshjeje me FBK për ri programim të pjesës së mbetur të borxhit.

II: Secili klub ka nënshkruar marrëveshje veç e veç me FBK-në duke u thirrur në parimet e cekura më lart dhe secili klub ka pasur afatet përkatëse dhe shumat përkatëse që është dashur ti paguajë çdo muaj kalendarik.

III: Marrëveshjet për shlyerje të obligimeve parashohin suspendimin si masë, në rast se klubi nuk respekton afatet e marrëveshjes.

Gjatë vendimmarrjes lidhur me pikën 2 të Vendimit Nr.5/2022, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

I: Komisioni ka vendosur që rishikimin e tërësishëm të gjendjes financiare ta bëjë pas ciklit të parë të garave të Superligë. I njëjti parim vlen edhe për ligat tjera.

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:

